

MODELI PËR DOKUMENTIN KONSULTATIV

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike””

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata, shoqëritë tregtare që operojnë në fushën e shërbimit privat të sigurisë fizike, Illyrian Guard sh.a, dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike””.

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektligjit, kryesisht mbi tërësinë e dispozitave që synojnë:

- Përmirësimin e kriterëve dhe standardeve në lidhje me aftësitë profesionale që duhet të ketë aplikanti (shoqëritë, administratorët, drejtuesit teknikë, punonjësit e shërbimit) për të marrë licencë dhe ushtrimin e aktivitetit.
- Përmirësimin e procedurave të verifikimit dhe kontrollit të personelit të SHPSF-ve, përfshirë aksesin tek të dhënat fizike e elektronike që kanë të gjitha institucionet shtetërore.
- Licencimin e qendrave private të trajnimit për personelin e sigurisë private.
- Ndalimin e dhënies me kontratë të këtij shërbimi nga një kompani tek tjetra me synim përmirësimin e kontrollit e përgjegjësisë për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata.
- Përmirësimin e procedurave të mbajtjes, përdorimit të armëve e forcës në veprimtarinë e tyre.
- Sigurimin e kriterëve dhe kushteve për përmbushjen e detyrueshme të qendrës së kontrollit.
- Përmirësimin e kriterëve, kushteve dhe specifikimeve teknike për mbajtjen, licencimin dhe përdorimin e mjeteve të blinduara.
- Njohjen e të drejtës shtetasve të huaj për të krijuar subjekt të SHPSF dhe për t’u punësuar në sektorin e sigurisë private në Shqipëri.
- Ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për trajtimin e ankesave të subjekteve ndaj masave administrative.
- Parashikimin e mundësisë së certifikimit të shtetasve të huaj si drejtues teknik dhe si punonjës shërbimi.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektligjit. Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen në projektligj.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë të paktën 20 ditë pune sikurse kërkon ligji, nëpërmjet publikimit në RENJK, nga data 17 tetor 2022 deri më 14 nëntor 2022.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektligjin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrisë Elektronike për projektaktin, në adresën elektronike: <http://ëëë.konsultimipublik.gov.al>.
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme Besmira Hoxha, në adresën: besmira.hoxha@mb.gov.al dhe specialistes Katerina Gjorgo, në adresën: katerina.gjorgo@mb.gov.al

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe /ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

znj. Besmira Hoxha - Koordinatore e Konsultimit Publik për MB, e-mail besmira.hoxha@mb.gov.al.

znj. Katerina Gjorgo - Specialiste e Drejtorisë së Programimit, Standardizimit, dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, e mail katerina.gjorgo@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Ky projektligj është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 59, datë 09.05.2022, me përfaqësues të Ministrisë së Brendshme përkatësisht:

-Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Rendit dhe Sigurisë Publike(1 përfaqësues);
-Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator (1 përfaqësues),

Me përfaqësues të Policisë së Shtetit (DPPSH) përkatësisht:

-Drejtoria e Rendit Publik (1 përfaqësues);
-Sektori i Shërbimeve të tretëve (2 përfaqësues);
-Sektori i Sigurisë Rrugore (1 përfaqësues);
-Sektori Juridik (1 përfaqësues).

Dhe 1 përfaqësues të Akademisë së Sigurisë.

Ky projektligj është konsultuar në mbledhjet e grupit të punës, përkatësisht në datat 19.05.2022, 31.05.2022, 10.06.2022, 17.06.2022 dhe 01.07.2022.

Gjithashtu, në datën 12.07.2022 u zhvillua tryeza në Ministrinë e Brendshme me rreth 15 përfaqësues të shoqatave dhe shoqërive private të sigurisë fizike, pasi krahas listës së mëposhtme me 12 përfaqësues të njoftuar nga DPPSH dhe të konfirmuar, kishte edhe përfaqësues të shoqërive të tjera të cilat u paraqitën.

Lista e shoqatave dhe e Shpsf-ve me aktivitet në disa qarqe të vendit të cilat u paraqitën në takim është si vijon:

1. Shoqata “Union Security Albania” Kryetari Gëzim Demiraj
2. Shoqata “Bashkimi Kombëtar i Shoqërive të Ruajtjes” (BKSHR) Kryetari Astrit Miho
3. Shpsf “Arb Security” titullar Perparim Hasani drejtues teknik Flamur Sala,
4. Shpsf “Aulona Pol-1” titullar Vasil Mërtiri, Ortak (Flamur Çela), drejtues teknik Ilir Gjoçi
5. Shpsf “Nazeri 2000” titullar Alfred Zylali, Ortaku Durim Nazeri, drejtues teknik Mehmet Baze
6. Shpsf “Rogat Security” titullar Begator Mane, drejtues teknik Dod Dodaj
7. Shpsf “Breçani Security” titullar Fatbardh Breçani, drejtues teknik Bashkim Boletini
8. Shpsf “Pelikani Security” titullar Vesel Demiraj, drejtues teknik Flamur Muka
9. Shpsf “Global Security” titullar Fatos Malaj, drejtues teknik Ibrahim Beraj
10. “Illyrian Guard” titullar Robert Lili, drejtues teknik Qamil Abedin
11. Shpsf “Myrto Security” titullar Hysni Myrtaj, drejtues teknik Skënder Mehmeti.
12. Shpsf “Anakonda Security” titullar Alfred Shehu.

Gjithashtu në takim ishin prezent edhe Zëvendësministri i Brendshëm, Drejtori i komanduar i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave për Rendin dhe Sigurinë Publike, përfaqësues të Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe përfaqësues të Akademisë së Sigurisë.

Projektligji është dërguar për mendim dhe bashkërendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Sfondi i propozimit legjislativ

Përgjatë zbatimit të ligjit nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, nga kontrollet e ushtruara ndaj subjekteve që kryejnë këtë veprimtari, janë evidentuar disa problematika, konkretisht:

- Moszbatimi i dispozitave të Kodit të Punës, lidhur me kohëzgjatjen e punës, punën e natës, punën me turne, si dhe trajtimi sipas dispozitave ligjore e nënligjore që referojnë pagën minimale të punonjësit të shërbimit të SHPSF-ve.

- Problematika në nivel teknik dhe menaxherial, si menaxhimi jo i mirë i shërbimeve nga drejtuesit teknik të SHPSF-ve, bashkërendimi i punës midis DVP-ve dhe subjekteve të SHPSF dhe kontrolli ndaj këtyre të fundit, mos bashkëpunimi me strukturat e tjera ligj zbatuese si me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Zyrën e Inspektoratit të Punës,
- Kontratat e nënshkruara midis subjekteve të SHPSF dhe institucioneve publike/jopublike, jo të gjitha janë të specifikuara në zëra lidhur me numrin e vendrojave për sigurimin e objekteve, transportimin dhe shoqërimin e vlerave monetare, çmimin e kontraktuar për një punonjës shërbimi, etj.
- Agjencia e Prokurimit Publik ka konstatuar se prokurimi i ruajtjes me punonjës shërbimi të SHPSF, ka sjellë mjaft problematika ndër vite, të cilat janë fokusuar në drejtim të përllogaritjes së fondit limit, ofertimit në këto procedura dhe procesit të ankimimit.
- Nga disa subjekte të SHPSF, nuk respektohet detyrimi ligjor për të planifikuar dhe realizuar shërbim referuar koeficientit 1.66 punonjës policie për vendroje.
- Punonjësve të shërbimit megjithëse punojnë për 30 apo 31 ditë në muaj (përfshijë muajin shkurt), në listë pagesat e dorëzuara për efekte të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore apo shëndetësore, u shënohen vetëm 22 ditë pune.
- Subjektet e SHPSF-ve, kanë bërë pagesa të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit, duke marrë për bazë pagën minimale bruto dhe jo pagën që punonjësi duhet të marrë për punën reale që ai bën gjatë një muaji, për rrjedhojë vlera e këtyre është e vogël.
- Subjektet e SHPSF vendosin vlerë page jo të përshtatshme referuar kërkesës së tregut dhe procedurave të prokurimit që kanë kryer me institucionet publike;

Propozimet

Qëllimi final i këtij ndryshimi të ligjit, është që mbi bazën e prioriteteve të Ministrisë së Brendshme dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të përvojës së arritur në fushën e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe të evidentimit të problematikave të deritanishme, nëpërmjet propozimeve për ndryshime në Ligjin 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, si dhe në aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e këtij shërbimi, të ngrihet në një shkallë më të lartë efektiviteti i këtij shërbimi.

Nga studimi i praktikës së deritanishme, arrijmë në konkluzion se duhet të rregullohen disa aktivitete në shërbimin privat të sigurisë fizike, duke përmbushur kështu edhe disa objektiva si:

1. Megjithëse ligji 75/2014 “Për SHPSF”, në këto vite luajti një rol të rëndësishëm në konfigurimin e shërbimit privat të sigurisë fizike, janë evidentuar problematika për të cilat është domosdoshmëri ndërhyrja apo rregullimi në ligj, me qëllim forcimin e kriterëve që nga marrja e licencës, trajnimi i punonjësve dhe ushtrimi i veprimtarisë së këtij shërbimi.

2. Mbas ndryshimeve të ligjit, është e nevojshme të bëhen ndryshime edhe në aktet nënligjore si udhëzimet e Ministrit të Brendshëm, procedurat standarde etj., me qëllim që ligji të marrë trajtë dhe të zbatohet në mënyrë të plotë.
3. Forcimin e rregullave të rekrutimit në subjektet e shërbimit privat të sigurisë fizike, me qëllim parandalimin dhe përjashtimin e personave të papërshtatshëm.
4. Rritjen e efikasitetit të kontroleve të strukturave të Policisë së Shtetit ndaj këtij shërbimi, duke vendosur një rregjim të rreptë kontrolli dhe monitorimi, sepse ende nga subjektet e SHPSF ka shkelje të ligjit, mos plotësim të detyrimeve ndaj punonjësve të punësuar etj.
5. Forcimin e regjimit të kontrollit të armatimit në zotërim të këtyre subjekteve, duke bërë reduktimin e tyre dhe eliminimin e armatimit ushtarak të sulmit nga arsenalit i tyre.
6. Parashikimin e masave shtrënguese në drejtim të automjeteve të blinduara që këtij shërbimi i janë dhënë në dispozicion, me qëllim përdorimin e tyre vetëm për qëllimin për të cilat ato janë miratuar.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projekt-ligjit të propozuar.

- Si i vlerësoni përcaktimet në projektligj, kryesisht mbi:

Afatin e vlefshmërisë të certifikatës për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik dhe punonjësin e shërbimit, kushtin e vendosur që secili çdo subjekt të ketë të drejtë të përfitojë njëkohësisht licencën e nënkategorisë 1.3.A, 1.3.B dhe 1.3.C, ndryshimet dhe shtesat e bëra mbi kriteret për certifikimin e drejtuesit teknik, kriteret për certifikimin e punonjësit të shërbimit, ndryshimet e kriterëve për licensim dhe pajisjen me licencë 1.3 A, 1.3.B, 1.3.C, ndryshimet mbi afatin e vlefshmërisë lidhur me ripërtëritjen e afatit të certifikatës për titullarin e subjektit, drejtuesin teknik dhe punonjësin e shërbimit dhe ndryshime të tjera rreth aplikimit për ripërtëritje dhe shtesave të bëra në kontratën mes palëve?

- A jeni dakord me parashikimet e përcaktuara në projektligj, kryesisht për:

Ndryshimet në disa prej kompetencave mbikëqyrëse të veprimtarisë së Shpsf-ve për Policinë e Shtetit, parashikimeve të bëra për menaxhimin e shërbimit të shpsf-ve, shtesave e ndryshimeve mbi përgjegjësitë e titullarit të subjektit të Shpsf-ve, shtesën mbi titullarin e qendrës së trajnimit privat, ndryshimeve e shtesave lidhur me përgjegjësitë e drejtuesit teknik, shtesave lidhur me përgjegjësinë e shërbimit, ndryshimit lidhur me të drejtën e mbajtjes së armëve të zjarrit dhe municionit, ndryshimit lidhur me pajisjet e shërbimit, ndryshimeve dhe shtesave mbi llojet e masave administrative, ndryshimeve dhe shtesave mbi gjobat për subjektin e licensuar dhe ndryshimeve mbi masat administrative për drejtuesin teknik, parashikimin e mundësisë së certifikimit të shtetasve të huaj si drejtues teknik dhe si punonjës shërbimi?